

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Sigunit® L-22 E

ADITIV I LËNGSHËM PËR PËRSHPEJTIMIN E BETONIT ME SPËRKATJE (SHOTCRETE)



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Sigunit® L-22 E është një akselerator i lëngshëm për aplikime me procesin e spërkatjes së thatë ose të lëngët.

PËRDORIMET

Sika® Sigunit® L-22 E është një akselerator i lëngshëm për procesin e spërkatjes së thatë ose të lëngët në aplikime si:

- Veshje nëntokësore (p.sh. në tunele)
- Stabilizim frontal gjatë gërmimit të tunelit
- Stabilizim i shkëmbinjve dhe shpateve
- Formim i një veshjeje të përhershme me beton të spërkatur

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

Efekti e akseleratorit varet nga përmbajtja e çimentos, lloji dhe moshë, temperatura dhe lloji i nënshtresës, temperatura e betonit për spërkatje (shotcrete), trashësia e shtresës dhe procesi / pajisja e spërkatjes. Raporti ujë/çimento e miksit bazë të betonit është një parameter tjetër i rëndësishëm i cili ndikon në efektin përshpejtues të Sika® Sigunit® L-22 E.

Sika® Sigunit® L-22 E dallohet nga vetitë e mëposhtme:

- Zhvillim i shkëlqyer i rezistencave të hershme
- Përmirëson ndërkapjen me nënshtresën dhe redukton kthimin mbrapsht të materialit (rebound) deri në <10% (në varësi të kushteve dhe përbërësve të miksit të betonit)
- Lejon prodhim të lartë (output), edhe > 25m³/h (në varësi të kushteve dhe përbërësve të miksit të betonit)
- Trashësia e madhe e shtresës mund të arrihet në një veprim të vetëm, edhe në aplikime tavanore
- Përmirësim i ndërkapjes së betonit të spërkatur me shkëmbin dhe betonit, duke e bërë spërkatjen tavanore më të lehtë
- Mund të përdoret me të gjitha llojet e çimentos
- Për shkak të efikasitetit të tij, nevojitet dozë shumë e ulët për rezultate të ngjashme në krahasim me produktet e tjera
- Pa klorure, nuk ndikon apo korrodon armaturën prej hekuri ose çeliku

MIRATIME / STANDARDE

Markë CE dhe Deklaratë Performance si aditiv për përshpejtimin e mpiksjes së betonit të spërkatur (Tabela 2) sipas EN 934-5:2007, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i njoftuar i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe testimin e llojit.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Tretësirë ujore sodium aluminate
Ambalazhi	IBC, furnizim rifuxho me porosi
Paraqitja / Ngjyra	Lëng, e verdhë e lehtë e turbullt
Jetëgjatësia	6 muaj nga data e prodhimit

Kushtet e magazinimit

Sika® Sigunit® L-22 E duhet të ruhet në enët origjinale, të padëmtuara dhe të pahapura
Sika® Sigunit® L-22 E hyn në reaksion me lagështinë atmosferike ose shiun dhe si pasojë duhet të ruhet gjithmonë në enë të mbyllura.
Sika® Sigunit® L-22 E duhet të ruhet vetëm në enë të pastra. Të shmanget bllokimi i ajrit. Mënyra më e mirë e mbushjes është nëpërmjet tubave të zhytur ose tubave të vendosur në bazpne depozitës. Enët duhet të mbyllen mirë.
Të mos ruhet në fuçi alumini.
Të mbrohet nga i ftohti i madh.
Shënim: Pas hapjes së enëve, materiali duhet të përdoret sa më shpejtë të jetë e mundur.

Dendësia

~1.5 kg/lit (në +20°C)

Vlera e pH

11 – 13 [1% për peshë në tretësirë ujore]

TË DHËNA TEKNIKE

Përbërja e betonit

Granulometria e pompës: Granulometria max. 8 mm deri në 16 mm
Konsistenca e betonit (varet nga pajisja e spërkatjes): Rrjedha e betonit 45 cm; U/Ç 0.48
Temperatura e betonit të freskët: > +15°C.
Për performancë më të mirë sistemi, rekomandohet përdorimi i mikseve me raporte të ulëta U/Ç (<0.50) në kombinim me superplastifikuesit kompatibël Sika® ViscoFlow® ose Sika® ViscoCrete®. Në rast kërkesash për pompueshmëri të lartë, përdorimi i Sika® Visco I-100 jep rezultate të shkëlqyera.
Reduktimi i sasisë së çimentos mund të arrihet duke përdorur aditivët e përshtatshëm nga Sika dhe recetën e saktë.

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Kompatibiliteti

Në përgjithësi, produktet e mëposhtme përdoren për të përmirësuar performancën ose vetitë e aplikimit të miksit bazë të betonit:

- Seritë Sika® ViscoCrete® / Sika® ViscoFlow®
- SikaTard®-930
- Sika® Visco I-100
- SikaFume® HR-E / Sikacrete® AR
- Sika-Air® Fine

Në të gjitha rastet rekomandohet kryerja e provave përpara kombinimit të produkteve.

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar

2-6% për peshë binderi (lidhësi)
Doza e saktë duhet të përcaktohet me testime paraprake.

Kufizime

- Temperatura e ambientit duhet të jetë > +1°C
 - Sika® Sigunit® L-22 E duhet të shtohet në ujën e përzierjes për procesin e thatë ose tek pajisja e përshtatshme e përzierjes për procesin e spërkatjes së lëngët.
 - Përdorimi i pajisjes nga personeli i aftë dhe përzierja e plotë brenda betonit janë thelbësore.
 - Karakteristikat e betonit të freskët (punueshmëria e saktë) duhet të adaptohen për t' u përshtatur me pajisjen e spërkatjes, kapacitetin e saj, temperaturën dhe kushte të tjera lokale.
 - Është thelbësor përdorimi i një pajisjeje matëse me saktësi të lartë për të patur një aplikim të saktë dhe pa ndërprerje. Doza e saktë varet nga cilësia e çimentos, cilësia dhe granulometria e agregateve, temperatura e betonit dhe akseleratorit, lagështia e nënshtresës, shkalla e prodhimit etj. Duhet të kryhen testime përshtatshmërie.
 - Vetitë e betonit të freskët (punueshmëria e duhur) duhet të rregullohen për të adaptuar makineritë për spërkatje betoni dhe kapacitetin e tyre, temperaturën e ambientit dhe kushte të tjera lokale.
 - Sika® Sigunit® L-22 E nuk ka kompatibilitet me akseleratorët me bazë silici dhe ata joalkalinë. Në rast se përdorimi i Sika® Sigunit® L-22 E do të bëhet me pompë ose pajisje tjetër ku më parë janë përdorur produkte të tilla, edhe në sasi të vogla, rekomandohet pastrimi i plotë i tyre përpara dhe pas përdorimit. Përzierja e Sika® Sigunit® L-22 E me akseleratorë jokompatibël mund të shkaktojë sedimentim ose solidifikim të menjëhershëm të miksit.
 - Disa superplastifikues nuk kanë kompatibilitet me Sika® Sigunit® L-22 E. Përzierja e superplastifikuesve jokompatibël me Sika® Sigunit® L-22 E mund të çojë në kthim mbrapsht me shumicë të materialit dhe humbje të rezistencave të betonit të spërkatur (shotcrete). Këshillohuni me departamentin tonë teknik.
 - Temperaturat e ulëta ndikojnë negativisht në performancën e Sika® Sigunit® L-22 E. Duhet të merren masa parandaluese për të mbrojtur akseleratorin dhe betonin.
 - Sika® Sigunit® L-22 E nuk ka kompatibilitet me akseleratorët jo-alkalinë si Sigunit®-49 AF.
- Kërkoni suport teknik nga Sika Albania SHPK.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositet pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Sigunit® L-22 E

Qershor 2019, Botimi 01.01

021401011000000213

SikaSigunitL-22E-sq-AL-(06-2019)-1-1.pdf

